

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë +



Dokument mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit Shoqëria e Sigurimit: Albsig Jetë sh.a.

Paketa: Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë +

Albsig Jetë sh.a. është shoqëri sigurimi jete, e licensuar me Vendimin Nr. 171, datë 13.09.2019, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtarinë në të gjitha klasat e sigurimit të jetës, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky produkt ofrohet në bashkëpunim me Allianz Partners. Ky produkt ofrohet në bashkësigurim me Albsig Jo-Jetë, licensuar me Vendimin nr. 10, dt. 19.07.2004 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtarinë në klasat e sigurimit të Jo-Jetës.

In proud partnership with



Ky dokument jep një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm, që lidhet me këtë produkt, por nuk është i personalizuar për ty. Të gjitha detajet që lidhen me informacionin para-kontraktor dhe kontraktor për këtë produkt janë të disponueshme dhe mund të shkarkohen në faqen zyrtare të internetit <https://iute.al/sigurimi-i-mbrojtjes-se-kredise/>. Në momentin që zgjedh të sigurohesh, duke pranuar kushtet e sigurimit dhe kryer apo autorizuar pagesën e primit të sigurimit, informacioni i mësipërm do të të ofrohet së bashku me certifikatën e sigurimit edhe në rrugë elektronike.

Çfarë është ky lloj sigurimi?

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë është një **produkt vullnetar sigurimi**, i cili ofrohet për personat që marrin kredi dhe i mbron ata nga rreziku i pamundësisë së shlyerjes së kredisë për shkak të ngjarjeve të papitura, si humbja e jetës apo aksidentet dhe sëmundjet që i bëjnë të paafte për punë. Në këtë mënyrë, vlera e kredisë së mbetur nuk trashëgohet te familjarët, por shlyhet nga sigurimi.

Në rast të ndodhjes së një prej ngjarjeve të listuara në seksionin e mbulimeve, shoqëria e sigurimit paguan pjesën e mbetur të detyrimit të kredisë, sipas kushteve të përgjithshme të kontratës së sigurimit. **Ky produkt nuk përbën detyrim për marrjen e kredisë, por është tërësisht në vullnetin e kredimarrësit.**



Çfarë mbulohet?

- ✓ Zbritje deri në 35% në rjetin spitalor Albsig
- ✓ Shërbimi "Opinionit i Dytë Mjekësor" nga qendra mjekësore të specializuara në botë
- ✓ Paaftësia e përkohshme apo e plotë e përhershme si pasojë e sëmundjeve ose shkaqeve aksidentale
- ✓ Humbja e jetës si pasojë e shkaqeve natyrore apo aksidentale
- ✓ Sigurim i shëndetit në udhëtim 1-vjeçar në Evropë



Ku jam i mbuluar?

- ✓ Në gjithë botën
- ✓ Sigurimi i shëndetit në udhëtim është i vlefshëm vetëm në territorin gjeografik të Evropës. Referoju linkut [këtu](#) për të parë listën e shteteve të mbuluara

Në rast dëmi, kontaktoni:

- Për shërbimin e "Opinionit të Dytë Mjekësor," të lutemi të raportosh ngjarjen brenda 3 ditëve nëpërmjet linkut: <https://portal.affinity.iute.com>
- Për dëme shëndetësore ose aksidentale, të lutemi të raportosh ngjarjen brenda 3 ditëve nëpërmjet linkut: <https://portal.affinity.iute.com> ose kontakto Albsig Jetë: **Tel.: +355 42254664 Email: contact@albsig-jete.al**
- Për dëme që lidhen me Shëndetin në Udhëtim, kontakto direkt me nr. **+43 152 503 6341**



Cilat raste nuk mbulohen?

- ✗ Je në dijeni që do të mbetesh i papunë ose do të dalësh në pension Nuk je rezident i përhershëm në Shqipëri
- ✗ Je punësuar për më pak se 6 muaj ose vetëpunësuar për më pak se 12 muaj para policës Puna është sezonale, e përkohshme ose stazh
- ✗ Kontrata përfundon dhe nuk rinovohet
- ✗ Jep dorëheqjen ose refuzon punë alternative
- ✗ Papunësi për shkak të luftës, terrorizmit, sporteve ekstreme, sëmundjeve ekzistuese, alkoolit/drogës
- ✗ Vetëvrasje, dëmtime të qëllimshme, sëmundje natyrore, infeksione Je në dijeni të ndonjë sëmundjeje të afërt
- ! Lexo kushtet e plota të policës për detaje
- ! Në rastin e sigurimit të shëndetit në udhëtim 1-vjeçar në Evropë:
- ✗ Çdo kujdes për çdo sëmundje, lëndim ose gjendje mjekësore që nuk ka filluar gjatë udhëtimit tuaj jashtë vendit.
- ✗ Ky mbulim nuk përfshin kujdes mjekësor pas përfundimit të periudhës së sigurimit dhe as trajtime për gjendje që nuk kanë filluar gjatë udhëtimit jashtë vendit.
- ✗ Nuk mbulohen shërbimet jo-urgjente, përfshirë kontrollet rutinë, trajtimet kozmetike, kujdesin afatgjatë, rehabilitimin dhe trajtimet eksperimentale.
- ✗ Në rast emergjencash të menjëhershme ose kërcënuese për jetën, duhet kërkuar menjëherë ndihmë mjekësore lokale.



A ka kufizime në mbulim?

- ! Individë më të rinj se 18 vjeç apo mbi 64 vjeç Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm
- ! Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm
- ! Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore paranoja, sindroma organiko-cerebrale

Në rastin e sigurimit të shëndetit në udhëtim 1-vjeçar në Evropë: ?

- ! Ky mbulim nuk përfshin gjendjet paraekzistuese, vetëdëmtimin apo vetëvrasjen, si dhe shtatzëninë, lindjen normale dhe trajtimet e fertilitetit, përveç rasteve kur parashikohen shprehimisht.
- ! Përrjashtohen gjithashtu humbjet që lidhen me abuzimin me alkoolin apo drogën, veprimet e qëllimshme, neglizhencën e rëndë dhe aktivitetet me rrezik të lartë ose të paligjshme.
- ! Ngjarje si epidemi/pandemi, fatkeqësi natyrore, luftë, terrorizëm apo ndërhyrje nga autoritetet mbulohen vetëm nëse janë të përfshira specifikisht në policë.
- ! Po ashtu, nuk mbulohen humbjet që lidhen me konsumimin normal, amortizimin, defektet e prodhimit apo dështimin financiar të furnitorëve të udhëtimit.

Periudha e kufizimit

- ! 30 ditët nga Data e Fillimit gjatë së cilës nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundrejt Policës, me përjashtim të Humbjes së Jetës

Periudha e pritjes

- ! Numri i ditëve pas të cilave ti mund të bësh një kërkesë dhe të marrësh çdo përfitim mujor për një ngjarje të mbuluar:



Cilat janë detyrimet e mia?

- Të paguash primin e sigurimit, në mënyrë që mbulimi të hyjë në fuqi.
- Të lexosh me kujdes informacionin para-kontraktor dhe të japësh dakordësinë për t'u bërë pjesë e kësaj skeme sigurimi, vetëm pasi të jesh bindur që ky sigurim është i përshtatshëm për ty, por në çdo rast përpara se të vijosh me pagesën e primit të sigurimit.
- Të na njoftosh nëse ka ndryshime në rethanat e tua që të bëjnë të papërshtatshëm për të përfutur këtë mbulim.



Kur dhe si paguaj?

- Primi mund të paguhet njëherësh ose nëpërmjet planit me këste me interes zero, të mundësuar vetëm për klientët kredimarrës të lute.
- Primi mund të paguhet nëpërmjet të gjitha mjeteve të njohura të pagesave të ligjshme në Republikën e Shqipërisë. **lutePay nuk pranon pagesa me para në dorë.**



Si mund ta anuloj kontratën?

- Ti ke të drejtë ta anulosh kontratën vetëm brenda 14 ditëve nga lëshimi i Certifikatës së Sigurimit, që përkon me datën e fillimit të mbulimit
- Ne do të të rimbursojmë plotësisht primin e paguar, përveç rasteve kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit
- Për ta anuluar kontratën, duhet të bësh një njoftim me shkrim pranë lutePay. Nëse ke shlyer plotësisht kredinë, kontrata do të anulohet automatikisht
- Përtej afatit 14-ditor, nuk ka rimbursim të primit të sigurimit



Kur fillon dhe kur mbaron mbulimi me sigurim?

- **Mbulimi fillon** në datën e shënuar në Certifikatën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit.
- **Mbulimi përfundon kur:**
 - Ti anulon mbulimin brenda periudhës së lejuar 14-ditore
 - Huaja është shlyer plotësisht, shlyer para kohe apo rrefinancuar
 - Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe siguroesi i ka paguar përfituesit shumën e dëmshpërblimit apo është marrë përfitimi maksimal i lejuar sipas kësaj Police
 - Nuk jeton/punon më në Republikën e Shqipërisë
 - Opinioni i dytë mjekësor dhe Shëndeti ne udhëtim ofrohen për një periudhë 1-vjeçare nga hyrja ne fuqi e sigurimit.

lutePay SH.P.K., e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik NIPT M022090020, është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në tregun e sigurimit të jetës me Nr. Licencë 1922/1, datë 24.11.2023.

Kontakte për pyetje apo më shumë informacion:

Email: info@iute.al **Nr. Tel:** 044 505 060

Adresa: Rruga "Andon Z. Çajupi", Pallati Nr.3, Hyrja Nr.2, Kati Nr.3, Tiranë

Stafi ynë teknik është i gatshëm t'i përgjigjet çdo pyetjeje apo paqartësie që mund të kesh.

